



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2771/7 prot.

Datë 15.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon - AI” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82700-10-09-2023, me objekt: “Blerje materiale kompjuterike”, me fond limit 3,477,567 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Sinteza Co” SHPK me NIPT K11324003F dhe adresë: Rruga e Barrikadave, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime
Qarku Shkodër SH.A.
Lagjia 3 Heronjte, rruga Marin Biçikemi, Shkoder
- Subjekte të Interesuara:** “Rikon - AI” SHPK me NIPT L22119010H dhe adresë:
Njesia Administrative Kashar, Rruga Ismail Qemali,
ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht, Tiranë.

Në datën 09.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3581, si dhe nr. protokollit 2771/2023 datë 09.11.2023 i operatorit ekonomik “Sinteza Co” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-82700-10-09-2023, me objekt: “Blerje materiale kompjuterike”, me fond limit 3,477,567 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës-Kanalizime Qarku Shkodër SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rikon - AI” SHPK në procedurën e prokurimit

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) **pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime**”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat, operatori ekonomik ankimes “Sinteza Co” SHPK, me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3581, si dhe nr. protokollit 2771/2023 datë 09.11.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Rikon - AI” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Rikon - AI” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.2 Për kapacitetin teknik:

2.2.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë prej 20% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vertetuar me dokumentacionin vertetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.2.3.Operatori Ekonomik pjesemarres, duhet te paraqese Autorizim nga prodhuesit ose distributor i autorizuar , i cili merr persiper te furnizoje Kandidatin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi i prodhuesit duhet te permbaje te dhenat te plota kontaktuese te prodhuesit si telefon, email, website).

2.2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog të detajuar për produktet e ofruara në këtë procedure prokurimi. Katologu duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 15.12.2023.

(Korrigjuar me Vendimin nr. 1307/2023, datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.)

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Tërnova

Nënkryetar

Fiorent Zguro